



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr. 197, datë 17.04.2024

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga raportore znj. Emona Muçi,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
 2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu, në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjor në vendimet burim vlerësimi për gjyqtaren {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“...Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se subjekti rivlerësimit {...} identifikon normën ligjore të zbatueshme në funksion të zgjidhjes së çështjes gjyqësore. Ai e analizon normën penale në raport me rrethanat konkrete të mosmarrëveshjes dhe nxjerr konkluzione mbi çështjen nga zbatimi i saj. Ai ka njohuri të konsoliduara për procedurën e shqyrtimit të çështjeve penale. Merr përgjithësisht në analizë, kryesisht kompetencën lëndore dhe tokësore, për shkak të gjykimit të çështjeve penale me të mitur (seksion i ngritur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë në zbatim të Dekretit nr. 5351 datë 11.06.2007 të Presidentit). Gjykimet penale të vëzhguara janë shqyrtuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar, me kërkesë të të pandehurit dhe me pëlqimin e prokurorit (shih dosjet 1, 2, 3 dhe 4)...Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Analizon normën ligjore materiale të zbatueshme në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Gjyqtarja {...} kujdeset për përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes, si dhe për identifikimin e ligjit të zbatueshëm, duke identifikuar sipas rastit ligjin e posaçëm, por nuk identifikon praktikën unifikuese gjyqësore, Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, si pjesë e legjislacionit të brendshëm....”*

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Vendimet gjyqësore burim vlerësimi në rastin konkret ndahen në dy grupe kryesore për shkak të lëndës (civile dhe penale), kategorizim i cili ndikon edhe në mënyrën e përcaktimit dhe analizimit të fakteve të çështjes, në përcaktimin e natyrës së saj dhe identifikimin e ligjit të zbatueshëm.

Në çështjet civile, në dy vendimet e analizuara, gjyqtarja përcakton dhe përshkruan në mënyrë të përmbledhur faktet e çështjes në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit. Paraqitja e fakteve të çështjes, edhe pse e pa veçuar në aspektin vizual, është e qartë dhe bëhet duke integruar edhe provat mbi të cilat kanë rezultuar faktet konkrete dhe pretendimet e palëve lidhur me faktin objekt shqyrtimi dhe kërkimet e tyre në raport me objektin e mosmarrëveshjes. Përveç përshkrimit të fakteve të çështjes në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit, së bashku me referimin tek provat mbi të cilat ato mbështeten, rrethanat e faktit rimerren në shqyrtim në pjesën e arsyetimit ligjor, me qëllim për të mbështetur argumentet e gjyqtarës, në shërbim të konkluzioneve sa i përket objektit të padisë apo pretendimeve të palëve ndërgjyqëse.

Në çështjet penale, në vendimet e analizuara, referuar natyrës së gjykimit (*gjykim penal themeli ose kërkesë penale*), apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi përcaktimit të fakteve të çështjes dhe përshkrimit

të tyre në disa pjesë të arsyetimit të vendimit, duke integruar në përshkrimin e tij provat mbi të cilat ka rezultuar i mbështetur fakti konkret. Në këto vendime, rrethanat e faktit vijnë menjëherë pas prezantimit të çështjes dhe arsyetimit lidhur kërkesat procedurale të palëve, sikurse është rasti i pranimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar. Në çështjet penale të themelit, gjyqtarja paraqet në mënyrë të hollësishme dhe koncize faktet e provuara në gjykim, duke i përshkruar ato nëpërmjet referimit dhe analizës së provave në mënyrë të integruar me njëra tjetrën. Në rastet në të cilat është proceduar me gjykim të shkurtuar, në përfundim të përshkrimit të rrethanave të faktit, gjyqtarja përcakton duke i renditur tërësinë e provave mbi të cilat ka rezultuar i provuar fakti, duke iu referuar fashikullit të prokurorit të kthyer në fashikull gjykimi, si dhe duke referuar disa nga provat e administruara të cilat në vlerësimin e saj paraqesin rëndësi specifike për procesin e të provuarit të faktit penal.¹ Në çështjen në të cilën objekt i gjykimit ka qenë kërkesa për vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi, rrethanat e faktit, së bashku me rrethanat procedurale të arrestimit apo caktimit të masës, përcaktohen në pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimit, duke referuar provat e administruara në proces dhe faktet konkrete të çështjes apo elementët proceduralë për të cilët referojnë provat e administruara, duke ndjekur rendin kronologjik të prezantimit të tyre.²

- Identifikimi i natyrës së çështjes

Në tërësinë e vendimeve të analizuara, identifikimi dhe përshkrimi i qartë, i saktë i faktit juridik objekt shqyrtimi, pavarësisht nëse natyra e çështjes është përcaktuar ose jo shprehimisht nga gjyqtarja në arsyetim, sjell si pasojë identifikimin në mënyrë të qartë të marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur konflikti në rastin e çështjeve civile, ose të natyrës së çështjes penale objekt gjykimi, duke orientuar qartë lexuesin për thelbin e çështjes, si dhe duke shërbyer si element orientues për arsyetimin ligjor të vendimit, në bazë të llojit të çështjes (penale themeli, kërkesë penale apo çështje civile themeli).

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu edhe me identifikimin e ligjit të zbatueshëm procedural dhe material në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, rezulton se në të gjitha vendimet, gjyqtarja identifikon ligjin e zbatueshëm, citon në disa raste dispozita të ligjit material ose procedural, si dhe analizon kur është vlerësuar e nevojshme përmbajtjen e tyre, në mënyrë të integruar me faktin, ose në mënyrë të pavarur, para aplikimit mbi faktet e çështjes. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit në dy kategori: (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, sa i përket identifikimit të ligjit të zbatueshëm procedural dhe material, rezulton si më poshtë:

¹Vendimet nr.620, datë 11.12.2014, nr.92, datë 22.02.2016, nr.595, datë 06.11.2015, nr.168, datë 07.04.2015, nr.585, datë 27.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

²Vendimi nr.344, datë 04.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

(i) Në dy vendimet civile gjyqtarja identifikon ligjin material dhe procedural të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, konkretisht në çështjen me objekt “*Pavlefshmëri veprimi juridik (testamenti)*”, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale relevante nenet 379 dhe 407 të Kodit Civil lidhur me pavlefshmërinë e testamentit, në rastet e përjashtimit nga trashëgimia ligjore të trashëgimtarëve të mitur ose të paafte për punë, si dhe lidhur me rezervën ligjore.³ Në çështjen me objekt “*Njohjen e pavërtetësisë së dokumentit*”, gjyqtarja në mbështetje të arsyetimit të saj lidhur me kërkimet për pavërtetësi shënimesh, identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 32/c të K.Pr.Civile dhe nenin 6 të ligjit nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”.⁴

(ii) Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon, citon dhe në disa raste analizon ligjin e zbatueshëm, procedural dhe material, si pjesë të integruar të arsyetimit të vendimit, për të vlerësuar rrethanat procedurale të çështjes, apo për të analizuar elementët e figurës së veprës penale, përcaktimin dhe individualizimin e dënimit dhe aplikimin e dënimeve alternative, disponimin për provat materiale, etj.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, në vendimet penale të analizuara, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, si edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal. Konkretisht, gjyqtarja identifikon në funksion të cilësimit juridik të faktit penal nenet 278 dhe 300 të K.Penal në lidhje me veprat penale të “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” dhe “Moskallëzimit të krimi”;⁵ nenin 134 të K.Penal në lidhje me veprën penale të “Vjedhjes”;⁶ nenin 237 të K.Penal në lidhje me veprën penale “Goditje për shkak të detyrës”;⁷ nenin 291 të K.Penal në lidhje me akuzën për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”;⁸ nenin 89 të K.Penal në lidhje me akuzën “Plagosja e lehtë me dashje”;⁹ nenet 284/1 dhe 280 të Kodit Penal në lidhje me veprat penale të “Kultivimi i bimëve narkotike” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”.¹⁰ Në këtë rast gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të ligjit të posaçme, në funksion të argumentimit lidhur me anën objektive të veprës penale, ligjin nr. 7975, datë 26.07.1995, “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”. Gjithashtu, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të personit të dyshuar për të cilin kërkohet vendosja e një mase sigurimi personal, gjyqtarja referon nenin 76 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Vrasja me dashje”.¹¹

³Vendimi nr.2485, datë 13.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

⁴Vendimi nr.2478, datë 12.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

⁵Vendimi nr.470, datë 15.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

⁶Vendimet nr.471, datë 06.10.2014, nr.67, datë 13.02.2015, nr.620, datë 11.12.2014 dhe nr.544, datë 11.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

⁷Vendimi nr.168, datë 07.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

⁸Vendimet nr.489, datë 14.10.2014 dhe nr.159, datë 01.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

⁹Vendimi nr.92, datë 22.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

¹⁰Vendimet nr.595, datë 06.11.2015 dhe nr.585, datë 27.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

¹¹Vendimi nr.344, datë 04.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

Veç dispozitave të pjesës së posaçme të Kodit Penal, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh. në lidhje me parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues (neni 3 K.Penal),¹² kriteret dhe parimet në caktimin e llojit dhe masës së dënimit (neni 47 i K. Penal), dispozitat lidhur me dënimin me burg për të miturin (neni 51 i K.Penal),¹³ bashkimin e dënimeve (neni 55 i K.Penal),¹⁴ dënimet alternative (nenet 59 dhe 60 të Kodit Penal),¹⁵ etj.

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, referuar natyrës së çështjes (*çështje penale e fazës së hetimit apo themeli*) gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale si më poshtë:

- nenet 403 dhe 404 të K.Pr.Penale lidhur me procedimin me gjykim të shkurtuar, nenin 406 të K.Pr.Penale lidhur me mënyrën e caktimit të dënimit në rastet e procedimit me këtë lloj të posaçëm gjykimi;
- nenet 150 dhe 152 në lidhje me provat dhe çmuarjen e tyre, nenin 388 të K.Pr.Penale në rastin e deklaramentit të pafajshëm të autorit, për shkak se nuk provohet që vepra penale që i atribuohet të pandehurit, të jetë kryer prej tij, nenin 393 të K.Pr.Penale lidhur me shpenzimet procedurale në procesin penal;¹⁶
- nenin 190 të K.Pr.Penale në lidhje me provat materiale.¹⁷
- Në vendimin me objekt vleftësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit personal, gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të analizës së ligjshmërisë së arrestit (*nenet 251 dhe 252 të K.Pr.Penale*) dhe vlerësimit që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim (*nenet 228 dhe 229 të K.Pr.Penale*) në lidhje me kushtet dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit.¹⁸

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë, të saktë dhe të plotë të fakteve të çështjes, analizën dhe vlerësimin individual të tyre, identifikimin e natyrës së çështjes, si dhe identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes konkrete.

¹²Vendimi nr.470, datë 15.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

¹³Vendimet nr.92, datë 22.02.2016, nr.544, datë 11.11.2014, nr.620, datë 11.12.2014, nr.471, datë 06.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

¹⁴Vendimi nr.595, datë 06.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

¹⁵Vendimet nr.489, datë 14.10.2014, nr.585, datë 27.09.2016 dhe nr.595, datë 06.11.2015, nr.168, datë 07.04.2015 nr.470, datë 15.07.2016, nr.544, datë 11.11.2014, nr.620, datë 11.12.2014, nr.67, datë 13.02.2015 dhe nr.471, datë 06.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

¹⁶Vendimi nr.470, datë 15.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

¹⁷Vendimi nr.585, datë 27.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

¹⁸Vendimi nr.344, datë 04.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Gjyqtarja {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Analizon normën ligjore materiale të zbatueshme në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Gjyqtarja {...} kujdeset për përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes, si dhe për identifikimin e ligjit të zbatueshëm, duke identifikuar sipas rastit ligjin e posaçëm, por nuk identifikon praktikën unifikuuese gjyqësore, Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, si pjesë e legjislacionit të brendshëm. Ajo ka njohuri për procedurën e shqyrtimit të çështjeve gjyqësore penale në funksion të zgjidhjes së çështjes. I kushton rëndësi kërtimeve procedurale në raport me rregullat procedurale dhe shprehet me urdhra dhe vendime të ndërmjetme mbi to. Ka njohuri mbi llojet e procedurave të gjykimit, kryesisht gjykimet e posaçme penale kryesisht me gjykimin e shkurtuar (shih dosja nr 1, 2, 3 dhe 4) Tre dokumentet e përzgjedhura prej saj dhe 5 dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë e saj mbi veprat penale të vjedhjes (shih dokumenti nr 1, 3 dhe dosja 4), të goditjes për shkak të detyrës (shih dokumenti 2), të kultivimit të bimëve narkotike dhe mbajtjes pa leje të armëve të gjuetisë (shih dosja 1), të drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt (shih dosja 2), të plagosjes së lehtë me dashje (shih dosja 5) dhe për caktimin e masave të sigurimit personal (shih dosja 5). Tre vendimet gjyqësore të paraqitura nga vetë gjyqtarja përmbajnë të dhëna se janë ankimuar në Gjykatat më të larta 2 çështje, të cilat janë lënë në fuqi (shih dokumenti 1 dhe 2). Ndërsa ndër 5 dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se janë ankimuar 2 vendime, të cilat janë lënë në fuqi (shih dokumenti dosja 4 dhe 5). Së fundmi, duhet evidentuar fakti se veprimtaria e saj gjyqësore nuk ka qenë objekt i një numri të lartë ankesash”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike *procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen ose referohen, duke u shoqëruar në disa raste me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile ose të çështjes penale objekt shqyrtimi.

Sa i përket interpretimit të ligjit procedural, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton se gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi interpretimit të disa dispozitave procedurale që zbatohen mbi rrethanat procedurale, duke u ndalur vetëm në disa raste në interpretimin teorik të tyre dhe në shumicën e rasteve në aplikimin e drejtpërdrejtë të tyre mbi faktet e çështjes.

Në vendimet penale të analizuara, rezulton interpretimi abstrakt me qëllim dhënien e kuptimit të nenit 228 të K.Pr.Penale në lidhje me kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj të dyshuarit, si dhe natyrën kumulative të kushteve të përgjithshme dhe alternative të kushteve të posaçme për caktimin e masave të sigurimit personal;¹⁹ interpretimi i nenit 404 të K.Pr.Penale në lidhje me kushtet procedurale të pranueshmërisë së kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar.

Në vendimet civile të analizuara, normat referohen dhe citohen, duke u aplikuar mbi aspektet procedurale në funksion të të cilave ato referohen (*vlerën provuese të akteve zyrtare*), pa u shoqëruar me interpretim të pavarur të kuptimit të tyre, përveç interpretimit të nenit 32/c në lidhje me përcaktimin e natyrës së kërkesëpadisë si padi njohje dhe përcaktimin e interesit të ligjshëm të paditësit për të ngritur padinë konkrete.

Interpretimi i kufizuar i normave procedurale në vendimet civile të analizuara në rastin konkret duket se është kushtëzuar edhe nga objekti i mosmarrëveshjeve të trajtuara, të cilat nuk rezulton të kenë elementë apo aspekte procedurale të cilat janë vënë në diskutim, çka do të bënte të nevojshëm interpretimin e pavarur të dispozitave të caktuara procedurale.

Sa i përket interpretimit të ligjit material të zbatueshëm, sipas natyrës së vendimit, rezulton se gjyqtarja ka interpretuar dispozitat respektive në mënyrë të pavarur vetëm në disa raste, kryesisht në vendimet penale, ndërsa në rastet e tjera, pas citimit të dispozitave, vijon me aplikimin e tyre mbi faktet e çështjes në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa i shoqëruar ato me interpretim të kuptimit dhe qëllimit të tyre, kushtëzuar kjo edhe nga mungesa e kompleksitetit të çështjeve referuar natyrës së mosmarrëveshjeve civile apo çështjeve penale të trajtuara.

¹⁹Vendimi nr.344, datë 04.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

Në vendimet civile të analizuara, dispozitat janë cituar dhe zbatuar drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes, pa u shoqëruar me një interpretim të pavarur të tyre, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e thjeshtë e objektit të padive të trajtuara, të cilat konsistojnë në njohjen e pavërtetësisë së dokumenteve, apo pavlefshmërisë se veprimit juridik.

Në vendimet penale të analizuara, kryesisht në vendimet e themelit, gjyqtarja citon nenet e pjesës së posaçme të Kodit Penal dhe i interpreton ato në drejtim të vlerësimit lidhur me kualifikimin ligjor të faktit penal, si dhe analizës së elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën procedohet i pandehuri. Në këto vendime gjyqtarja ka interpretuar edhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në drejtim të përcaktimit të qëllimit të dënimit penal, kushteve dhe kritereve të individualizimit të dënimit, sipas parashikimeve të nenit 47 të Kodit Penal, si dhe kushteve të aplikimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit, sipas parashikimeve të nenit 59 të Kodit Penal, kushte të cilat referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktet e çështjes, duke u shoqëruar me një analizë të shkurtër të tyre, pa qëndruar në interpretimin e veçantë dhe abstrakt të tyre.

Në vendimin me objekt vleftësimin e ligjshëm të arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit personal, nuk rezulton të ketë interpretim të dispozitave të ligjit penal material, kushtëzuar nga objekti i kërkesës e cila nuk ka në fokus vlerësimin e ekzistencës dhe provueshmërisë së faktit penal apo elementëve të tjerë, në të cilat gjejnë zbatim dispozita të ligjit material, pasi është kërkesë me natyrë ngushtësisht procedurale.²⁰

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Nga tërësia e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtarja në disa raste, gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përmend dhe/ose zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet në disa raste duke i përmendur ato shprehimisht, dhe në raste të tjera, duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe analizës ligjore të vendimit. Nga tërësia e vendimeve, rezulton se gjyqtarja njeh dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- *Parimi i prezumimit të pafajësisë* i sanksionuar në nenin 4 të K.Pr.Penale dhe parimin procedural penal që ka lidhje të drejtpërdrejtë me përcaktimin e përgjegjësisë penale të autorit “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*”;²¹
- *Parimin e ligjshmërisë–nullum crimen, nulla poena sine culpa*, i referuar dhe po ashtu i nxjerrë nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur në të gjitha vendimet penale të themelit;
- *Parimi i veprimit të ligjit penal në kohë*, duke analizuar normat penale sipas ligjit të kohës kur ka ndodhur vepra penale dhe parashikimit të së njëjtës vepër në kohën e zhvillimit të gjykimit, duke konkluduar për zbatimin e ligjit penal favorizues, në respektim të nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 3 të Kodit Penal.²²
- Parimet e përgjithshme në caktimin e dënimit, *si të barazisë para ligjit, të drejtësisë*

²⁰ Vendimi nr.344, datë 04.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

²¹Vendimi nr.470, datë 15.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

²²Vendimi nr.470, datë 15.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, të humanizmit, përshtatshmërisë së llojit dhe masës së dënimit. Këto parime, pavarësisht se nuk citohen shprehimisht, rezultojnë të jenë zbatuar nga gjyqtarja në të gjitha vendimet penale të themelit.

- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante

Vetëm në një vendim të analizuar, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, apo edhe vendime të Gjykatës Kushtetuese*) në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, posaçërisht në rastet që lidhen me:

- *Gjykimin e shkurtuar*: Konstatohet se në vendimet penale burim vlerësimi edhe pse nuk është bërë në mënyrë specifike identifikimi i vendimit unifikues nr.2, datë 29.01.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pranimi apo jo i kërkesës për gjykimin e shkurtuar është bërë duke u bazuar në konkluzionet e arritura të vendimit unifikues e në këtë kontekst, rezulton të jetë zbatuar drejtpërsëdrejti ky vendim në të gjitha vendimet burim vlerësimi.
- *Cilësimin juridik të veprës penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”*: Gjykata mbështet konkluzionin e saj në cilësimin juridik të veprës penale edhe në zbatim të plotë dhe rigoroz të vendimit nr. 9/2016, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.²³

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi të mira të interpretimit të ligjit procedural dhe material penal, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me zgjidhjen e çështjes dhe vetëm në një rast ka identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese. Nuk evidentohet një analizë e veçantë e normave të ligjit, (*teorike dhe e pavarur nga fakti penal objekt shqyrtimi*), gjyqtarja referon dhe aplikon normën ligjore mbi faktet e çështjes, duke bërë zbërthimin e saj sipas elementëve të veprës penale, në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, e në vijim nxjerr konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë penale të autorit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

²³Vendimi nr.470, datë 15.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“...Vendimet gjyqësore të hartuara prej subjektit të rivlerësimit {...} përgjithësisht janë të qarta dhe të kuptueshme...Respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe...”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese. Nuk konstatohet përdorimi në çdo rast i shkronjave “ç” dhe “ë” në vendimet e analizuara. Nuk rezulton të jenë përdorur terma teknikë, apo fjalë që krijojnë konfuzion lidhur me kuptimin dhe kontekstin e përdorimit të tyre. Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim penal, gjyqtarja i referon ato në gjuhën shqipe.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të thjeshta, të ndërthurura me njëra tjetrën dhe të kuptueshme. Vendimet janë të organizuar përgjithësisht në paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër dhe duke përdorur fjali hyrëse për paragrafë të caktuar, me qëllim orientimin e lexuesit për përmbajtjen e tyre.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e thjeshtë dhe e kuptueshme e përdorur në arsyetim dhe mënyra e organizimit të mendimit, mundëson lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet me argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumentave ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*), etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Struktura e vendimeve përfundimtare është organizuar sipas kërkesave të legjislacionit procedural penal. Pjesa hyrëse e vendimit paraqitet e plotë, duke treguar të dhëna mbi gjykatën, trupin gjykues, sekretaren gjyqësore, palët, akuzat dhe pretendimet përfundimtare të palëve. Në pjesën arsyetuese, ajo orientohet drejt faktit të mosmarrëveshjes dhe pretendimeve të palëve. Përgjithësisht i analizon provat në funksion të përcaktimit të faktit penal, me përjashtim të dy rasteve ku ato paraqiten të listuara (shih dosja 1 dhe 3). Tek analiza ligjore, në disa raste citon dispozitat e zbatueshme dhe i analizon ato (shih dokumentet 1, 2 dhe 3, si dhe dosja 4), ndërsa në disa raste të tjera mjaftohet me referimin tek dispozitat ligjore (shih dosja 1, 2 dhe 3). Ajo përgjithësisht kushton rëndësi analizës së rrezikshmërisë shoqërore të të pandehurit, shkallës së fajit dhe rrethanave lehtësuese në*

caktimin e masës së dënimit.....Dispozitivi i vendimit hartohet prej saj në mënyrë të plotë dhe përgjithësisht është rrjedhojë e pjesës arsyetuese të vendimit. Aty disponohet rregullisht mbi fajësinë e të pandehurit, llojet dhe masat e dënimit, si dhe mbi veprimet dytësore që lidhen me vuajtjen e dënimit, provat materiale dhe shpenzimet procedurale. Në të gjitha rastet është konstatuar se në dispozitivin e vendimit shprehet për shpenzimet procedurale dhe gjyqësore. Aty tregohet e drejta dhe afati i ankimit”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar në hartimin e vendimit, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i referohet prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Konstatohet se vendimet civile përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile:

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave lidhur me gjykatën, koha dhe vendi i zhvillimit të gjykimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti dhe baza ligjore e padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur. Në pjesën përshkruese-arsyetuese gjejnë pasqyrim: rrethanat e fakteve të çështjes, siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi, parashtrimi në mënyrë të përmbledhur i pretendimeve të palëve, ku gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionet e saj. Pjesa e dispozitivit është e qartë, koncize, e thjeshtë dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me objektin e padisë, si dhe elementët e tjerë të vendimit lidhur me shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, etj. Gjyqtarja ndjek një strukturë pothuajse të njëjtë në paraqitjen e vendimeve përfundimtare, e cila është karakteristikë e qëndrueshme e gjyqtarës, çka i bën vendimet e saj tepër të qarta dhe të kuptueshme.

Po kështu, konstatohet se vendimet penale përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale:

Pjesa hyrëse përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohën e zhvillimit të gjykimit, të dhënave e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë, nenet përkatëse të Kodit Penal, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur. Pjesa përshkruese-arsyetuese e vendimeve gjithashtu ndjek një strukturë të mirëpërcaktuar, e cila ndiqet pothuajse në çdo rast, të ndarë në paragrafë (edhe pse jo me tituj të përcaktuar si p.sh “rrethanat e faktit”, “ligji i zbatueshëm”, “vlerësimi i gjykatës”), ku nga mënyra e pasqyrit të tyre në vendim, konstatohet lehtë dhe dukshëm kjo nënndarje. Organizimi i pjesëve të arsyetimit të vendimit ka ndjekur të njëjtën strukturë, duke filluar me paraqitjen e rrethanave procedurale të çështjes, paraqitjen e faktit penal të provuar gjatë gjykimit, përshkrimin e provave të marra gjatë gjykimit, analizën ligjore mbi provat dhe cilësimin juridik të veprës penale, si dhe caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, ku në fund evidentohen edhe disponimet

lidhur me kërkesën për disponimin mbi provat materiale dhe për shpenzimet procedurale dhe ato gjyqësore. Dispozitivi i vendimeve është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur në mënyrë të qartë të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me fajësinë e të pandehurve, akuzën përkatëse, nenet respektive të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar kur është aplikuar, kohën e fillimit të llogaritjes së tij, institucionin e vuajtjes së dënimit, disponimin e plotë për provat materiale, shpenzimet procedurale dhe ato gjyqësore, si dhe të drejtën e ankimit. Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë, koncize, e plotë, e lexueshme dhe e kuptueshme, duke bërë të qartë disponimin e gjykatës lidhur me të gjithë elementët e disponimit në vendimin përfundimtar, në funksion të qartësisë së tij për palët dhe lexuesin, si dhe të ekzekutimit të tij.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballlet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përse u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.²⁴

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

²⁴Vendimi i GJEDNJ, çështja *Hadjanastassiou vs Greqisë*, datë 16.12.1992, fq.33.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Në dy raste ky arsytim nuk ka qenë i detajuar (shih dosja 3 dhe 4). Në një rast ky arsytim ka qenë kontradiktor me faktin penal dhe dispozitivin e vendimit, por nuk ka sjellë pasoja, pas edhe pas kontrollit gjyqësor mbi ankimin e palëve nuk është cenuar nga gjykata e apelit (shih dosja 4)...Niveli i arsytimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor...Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga gjykatat më të larta, për shkak të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Në 4 rastet ku vendimi është ankimuar, pas shqyrtimit gjyqësor nga gjykatat më të larta, ka rezultuar se vendimet nuk janë cenuar. Së fundmi, tek të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se gjyqtarja arsyeton vendimet e ndërmjetme, të cilat paraqiten në tërësi me referenca ligjore”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se përgjithësisht, gjyqtarja paraqet një analizë të strukturuar të fakteve të çështjes, identifikon, citon dhe në disa raste analizon ligjin e zbatueshëm, e aplikon atë mbi faktet e çështjes dhe parashtron argumentet mbi mënyrën e zbatimit të ligjit, duke lidhur këto argumente me konkluzionet e arritura mbi kërkimet objekt padie, pretendimet e palëve, apo konkluzionin e saj mbi çështjet penale të shqyrtuara.

Kryesisht, në vendimet penale të themelit, gjyqtarja i kushton një vëmendje më të posaçme arsytimit të vendimeve, dhënies së argumenteve ligjore të plota lidhur me faktin penal objekt akuze, provueshmërinë e tij, cilësimin ligjor të faktit, si dhe autorësinë e të pandehurit. Në vendimet civile, arsytimi përqendrohet kryesisht në paraqitjen dhe analizën e rrethanave të provuara në gjykim, në raport me kërkimin objekt padie, pa u ndalur në mënyrë të posaçme në dhënien e argumenteve të zgjeruara ligjore mbi mënyrën e aplikimit të ligjit mbi faktet konkrete. Në këto vendime, ligji material dhe dispozitat procedurale referohen dhe zbatohen drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes, duke u lidhur menjëherë me konkluzionin e arritur, pa u ndalur në interpretimin e ligjit dhe integrimin e tij me argumentet e gjyqtarës mbi faktet e çështjes. Megjithatë, duket theksuar se cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik në një pjesë të vendimeve të analizuara, kryesisht në vendimet civile, është i kushtëzuar dhe nga natyra e mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila në këto raste ka natyrë të thjeshtë, duke kufizuar nevojën e kryerjes së një analize të zgjeruar ligjore.

Përgjithësisht, arsytimi i vendimeve paraqitet i plotë dhe i qartë, duke i kushtuar rëndësi argumentimit më të plotë dhe gjithëpërfshirës, veçanërisht në rastet kur ka qenë e nevojshme për shkak të ekzistencës së elementëve të diskutueshëm në raport me faktin penal ose civil objekt shqyrtimi. Në tërësi, arsytimi i vendimeve ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore në aspektin procedural dhe material civil apo penal, duke u ndalur në analizën dhe argumentimin e zgjeruar të tyre vetëm në disa raste, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Pavarësisht natyrës komplekse ose jo të çështjes, gjyqtarja ka evidentuar në çdo rast në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar më pas arsyetimin e vendimit, interpretimin e ligjit dhe përqasjen e tij të drejtpërdrejtë me faktin e provuar në gjykim, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Në disa prej vendimeve të analizuara rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës penale dhe civile, kur kjo rezulton e nevojshme, në shërbim të përcaktimit të natyrës së çështjes ose konkluzioneve të arritura lidhur me të, si p.sh: (i) *Instituti të masave të sigurimit personal*, duke përcaktuar dhe analizuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të zbatimit të masave të sigurimit, natyrës kumulative të kushteve të përgjithshme dhe natyrës alternative të kushteve të posaçme, si dhe kriteret për caktimin e tyre; (ii) *Instituti të dënimit dhe qëllimit të tij*, kushtet dhe kriteret për përcaktimin dhe individualizimin e dënimit, si dhe analizën e tyre në raport me rrethanat për të pandehurin konkret, në përputhje me provat dhe rrethanat e provuara në gjykim.

Pavarësisht peshës së arsyetimit ligjor, e cila nuk është e njëjtë në të gjitha vendimet e analizuara, në çdo rast mënyra e organizimit dhe paraqitjes së analizës së faktit dhe ligjit, si dhe argumentimit, përmban lidhjen logjike shkak-pasojë, mes çështjeve të shtruar për zgjidhje, referuar objektit të padisë civile ose objektit të çështjes penale, me konkluzionet e arritura nga gjyqtarja. Kjo lidhje në disa vendime vjen si pasojë e aplikimit të drejtpërdrejtë të ligjit të zbatueshëm mbi faktet e provuara në gjykim dhe në disa prej vendimeve vjen si pasojë e një analize më të plotë mbi interpretimin dhe dhënien e arsyeve të mënyrës së zbatimit të ligjit mbi faktet, në shërbim të konkluzioneve të arritura.

KONKLUZIONI

Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik, përmbush në përgjithësi standardet e procesit të rregullt ligjor, si dhe jep përgjigje të argumentuar për pretendimet e palëve, duke mbështetur konkluzionin e gjyqtarës. Analiza jo e plotë dhe e detajuar e provave të marra në gjykim me qëllim evidentimin e faktit penal, nuk i jep cilësi analizës dhe argumentimit logjik. E njëjta shkallë aftësie konstatohet edhe në aspektin e arsyetimit të mënyrës se si ligji zbatohet mbi faktet e provuara. Ky proces i dytë i metodologjisë së të shkruarit të mendimit juridik, bazohet më shumë në deduksione logjike, sesa në analizë ligjore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik”, vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	90

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e saj, si kur gjykon e vetme, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Nga analiza e 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} ka qenë brenda afatit standard apo ligjor”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja.

Nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për vetëm 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e gjykimit. Konkretisht:

- (i) Çështja e kategorisë “Kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake” (vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit), për të cilën është parashikuar si afat ligjor për përfundimin, afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë. Referuar vendimit nr. 344, datë 04.10.2014 të

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë rezulton se kërkesa për vlefësimin e arrestit dhe caktimin e masës ka si datë regjistrimi datën 02.10.2014 dhe datë vendimi datën 04.10.2014. **Rezulton që është respektuar afati 48 orë i parashikuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale për përfundimin e saj.**

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre dhe se edhe kjo çështje rezulton që të jetë përfunduar brenda afatit ligjor për përfundimin e saj, rezulton se raporti i shprehur në përqindje është 0% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjen e analizuar për të cilën ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, gjyqtarja pikëzohet 15 pikë pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej saj tej afatit ligjor, është 0%.*

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Nga analiza e 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} ka qenë brenda afatit standard apo ligjor. Në përllogaritjen e kohës efektive të mbajtjes për gjykim të dosjes nga gjyqtarja është përllogaritur data e shortimit të çështjes dhe data e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me vendim përfundimtar. Konkretisht, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 26 ditë (shih dokumenti 1), 1 muaj e 26 ditë (shih dokumenti 2), 2 muaj e 26 ditë (shih dokumenti 3), 1 muaj e 4 ditë (shih dosjen 1), 15 ditë (shih dosjen 2), 2 muaj e 26 ditë (shih dosjen 3) dhe 1 muaj e 15 ditë (shih dosja 4). Në drejtim të kohëzgjatjes së gjykimit duhet evidentuar se nga 2 ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarës {...} në Inspektoratin e ish-KLD-së, vetëm një ankesë (në vitin 2014) është

verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mungesë solemniteti në gjykim dhe ka rezultuar se, nuk ka patur shkelje nga e ana e gjyqtarës”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se për 10²⁵ çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së.²⁶

Konkretisht, referuar 3 vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja, konstatohet se:

- (i) Vendimi penal nr.471, datë 06.10.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë, me të pandehur A.R. dhe K.G., akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i K.Penal. Referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë regjistrimi 10.09.2014 dhe datë përfundimi 06.10.2014, pra rezulton që çështja ka përfunduar për 26 ditë, pra brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- (ii) Vendimi penal nr.67, datë 13.02.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë, me të pandehur F.M., E.B. dhe F.K., akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i K.Penal. Referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë regjistrimi 17.11.2014 dhe datë përfundimi 13.02.2015, pra rezulton që çështja ka përfunduar për 87 ditë, pra brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- (iii) Vendimi penal nr.168, datë 07.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë, me të pandehur M.B., akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Goditje për shkak të detyrës”, parashikuar nga neni 237 i K.Penal. Referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë regjistrimi 09.02.2015 dhe datë përfundimi 07.04.2015, pra rezulton që çështja ka përfunduar për 57 ditë, pra brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).

Referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short,²⁷ konstatohet se:

- (i) Çështja penale nr. 860 regj.them, datë 02.10.2015, me të pandehur J.B., akuzuar për kryerjen e veprave penale “Kultivimi i bimëve narkotike” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, të parashikuara nga neni 284/1 dhe 280 të K.Penal, e përfunduar me vendimin nr.595, datë 06.11.2015. Referuar të dhënave konstatohet se kjo çështje ka

²⁵Nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykim

²⁶Sipas vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjyqimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm... e. Gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm, jo më tej se 6 muaj...”

²⁷Sikundër kemi analizuar nga 11 çështje të përzgjedhura me short, 1 prej tyre parashikon afat ligjor dhe 10 afat standard minimal kohor për përfundimin e tyre.

- përfunduar për 25 ditë, **pra brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);**
- (ii) Çështja penale nr. 647 regj.them, datë 29.09.2014, me të pandehur L.P., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuara nga neni 291 i K.Penal, e përfunduar me vendimin nr.489, datë 14.10.2014. Referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për 15 ditë, **pra brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);**
- (iii) Çështja penale nr. 1001 regj.them, datë 27.11.2015, me të pandehur N.H., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Plagosja e lehtë me dashje”, e kryer në bashkëpunim, parashikuara nga neni 89 e 25 i K.Penal, e përfunduar me vendimin nr.92, datë 22.02.2016. Referuar të dhënave konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për 87 ditë, **pra brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);**
- (iv) Çështja penale nr. 731 regj.them, datë 27.10.2014, me të pandehur K.K., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhja”, mbetur në tentativë, parashikuara nga neni 134/1 e 22 i K.Penal, e përfunduar me vendimin nr.620, datë 11.12.2014. Referuar të dhënave konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për 45 ditë, **pra brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);**
- (v) Çështja civile nr.2884 regj.them, datë 10.09.2013, me objekt “Njohje pavërtetësisë së dokumentit”, i është caktuar gjyqtarës me short në datën 12.09.2013 dhe ka përfunduar me vendimin nr.2478, datë 12.11.2013. Referuar të dhënave konstatohet se çështja ka përfunduar për 61 ditë, **pra brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm.**
- (vi) Çështja civile nr.1915 regj.them, datë 15.04.2013, me objekt “Pavlefshmëri veprimi juridik”, i është caktuar gjyqtarës me short në datën 16.04.2013 dhe ka përfunduar me vendimin nr.2485, datë 13.11.2013. Referuar të dhënave konstatohet se çështja ka përfunduar për 6 muaj e 28 ditë. Çështja i është caktuar gjyqtarës me short në muajin prill të vitit 2013 dhe ka përfunduar në muajin nëntor të po atij viti. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore të vitit 2013 (30 ditë),²⁸ kjo çështje do të kishte përfunduar për 5 muaj e 28 ditë, **pra brenda afati 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm dhe e tillë do të konsiderohet.**
- (vii) Çështja penale nr. 673 regj.them, datë 10.10.2014, me të pandehur I.B. dhe Xh.B., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhja”, kryer në bashkëpunim, parashikuara nga neni 134/1 e 25 i K.Penal, i është caktuar gjyqtarës me short në datën 14.10.2014 dhe ka përfunduar me vendimin nr.544, datë 11.11.2014. Referuar të dhënave konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për 28 ditë, **pra brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);**
- (viii) Çështja penale nr. 372 regj.them, datë 25.02.2015, me të pandehur E.L., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuara nga neni 291 i K.Penal, i është caktuar gjyqtarës me short në datën 26.02.2015 dhe ka përfunduar me vendimin nr.159, datë 01.04.2015. Referuar të dhënave konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për 34 ditë, **pra brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);**
- (ix) Çështja penale nr. 720 regj.them, datë 10.06.2016, me të pandehur A.P., M.Q., E.K. dhe E.D., akuzuar për kryerjen e veprave penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” dhe “Moskallëzim krimi”, parashikuara nga nenet 278/2 dhe 300/1 të K.Penal, i është caktuar gjyqtarës me short në datën 14.06.2016 dhe ka përfunduar me vendimin nr.470, datë 15.07.2016. Referuar të dhënave konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për 31 ditë,

²⁸Neni 24/2 i ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes përcaktonte se “Gjyqtari përfiton leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore bëhet në muajin gusht....”.

pra brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);

- (x) Çështja penale nr. 815 regj.them, datë 21.07.2016, me të pandehur E.X., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuara nga neni 284/1 i K.Penal, i është caktuar gjyqtarës me short në datën 26.07.2016 dhe ka përfunduar me vendimin nr.585, datë 27.09.2016. Referuar të dhënave konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për 63 ditë, ***pra brenda afatit 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 13 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër analizohen edhe më sipër, rezultoi se të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së, duke përbërë **0%** të çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuar.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej saj tej standardit minimal, është 0 %.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Nga analiza e 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} ka qenë brenda afatit standard apo ligjor. Në përllogaritjen e kohës efektive të mbajtjes për gjykim të dosjes nga gjyqtarja është përllogaritur data e shortimit të çështjes dhe data e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me vendim përfundimtar. Konkretisht, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 26 ditë (shih dokumenti 1), 1 muaj e 26 ditë (shih dokumenti 2), 2 muaj e 26 ditë (shih dokumenti 3), 1 muaj e 4 ditë (shih dosjen 1), 15 ditë (shih dosjen 2), 2 muaj e 26 ditë (shih dosjen 3) dhe 1 muaj e 15 ditë (shih dosja 4). Në

drejtim të kohëzgjatjes së gjykimit duhet evidentuar se nga 2 ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarës {...} në Inspektoratin e ish-KLD-së, vetëm një ankesë (në vitin 2014) është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mungesë solemniteti në gjykim dhe ka rezultuar se, nuk ka patur shkelje nga e ana e gjyqtarës”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykatat e Shkallës së Parë në periudhën e vlerësimit. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 10 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (*13 çështjet e marra në analizë, i përkasin kategorisë së çështje penale themeli-krime dhe civile themeli*), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 11 çështje në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, rezulton të jetë rreth 45 ditë, ose 1 muaj e 15 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 9 muaj për gjykimin e çështjeve penale krime në gjykatën e shkallës së parë.
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 çështjet në kategorinë e çështjeve “Civile themeli”, rezulton të jetë rreth 135 ditë, ose 4 muaj e 15 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 muaj për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm në gjykatën e shkallës së parë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor. Për këtë arsye, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është e lartë dhe pikëzohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 98.2%. Sipas pikës 3 shkronja “a”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës penale, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 100 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje penale) në një vit kalendarik. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 300 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje penale) për tre vjet. Duke zbatuar këtë rregull në rastin e subjektit të rivlerësimit {...} konstatohet se ngarkesa e tij sasiore ka qenë mbi standardin minimal sasior”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për efekte të organizimit të shortit për përzgjedhje, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtarja {...} ka përfunduar 324 çështje nga të cilat 21 çështje civile të përgjithshme, 117 çështje penale, 32 kërkesa penale, 138 kërkesa penale në fazën e hetimit (masa sigurimi dhe përgjime) dhe 16 kërkesa civile, ose 138 çështje me palë kundërshtare sipas standardit.

Për aspektin sasior, sipas pikës 3, germa “a” të vendimit të ish KLD-së, gjyqtari i shkallës së parë i dhomës penale, si relator, jo më pak se 100 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje penale), i llogaritur në periudhë 3-vjeçare jo më pak se 300 çështje penale.

Referuar të dhënave të pasqyruara në vërtetimin nr.53 prot., datë 19.01.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkëlidhur Formularit të vetëvlerësimit,²⁹ shënohen të dhënat statistikore të ndara sipas viteve kalendarike dhe konkretisht:

- Në vitin 2014, i janë caktuar si çështje të reja³⁰ 62 çështje, ka përfunduar 48 çështje;
- Në vitin 2015, i janë caktuar 145 çështje, ka përfunduar 157 çështje;
- Në vitin 2016, i janë caktuar 132 çështje, ka përfunduar 128 çështje.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabela me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës 08.10.2013-08.20.2016, duke u bazuar në të dhënat statistikore bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit për periudhën e plotë 2014-2016, e cila në këtë rast konsiderohet periudhë e plotë vlerësimi, rendimenti duhet të përcaktohet referuar

²⁹Faqe 10 e dosjes së rivlerësimit

³⁰“Çështje të reja” janë ato që janë regjistruar të reja brenda një viti kalendarik, ku nuk përfshihen çështjet e mbartura nga vitet paraardhëse

raportit të çështjeve të përfunduara 333 çështje, me çështjet e caktuara 339 çështje gjatë periudhës së vlerësimit, në masën 98,2%.

Duke konsideruar faktin që në vitin 2014³¹ gjyqtarja ka ushtruar detyrën për vetëm 4 muaj, treguesit statistikorë për këtë periudhë nuk mund të japin të dhëna të sakta për treguesin e rendimentit, duke qenë se gjyqtarja ka filluar punë në muajin shtator dhe për pasojë ka ushtruar detyrën për vetëm 4 muaj. Për rrjedhojë, çështjet e caktuara nuk mund të përfundonin për një periudhë kohore të barabartë me 4 muaj, kohë kjo e barabartë ose më e shkurtër se standardi minimal kohor për kategorinë çështjeve penale (krime dhe kundërvajtje). Rrjedhimisht, treguesit e vitit 2014 nuk mund të merren në konsideratë në përlllogaritjen e rendimentit të përfundimit të çështjeve dhe kjo përlllogaritje do të bëhet mbi të dhënat statistikore të viteve të plota të ushtrimit të detyrës, përkatësisht viteve 2015 dhe 2016.

Duke iu referuar numrit të çështjeve të përfunduara, me ato të caktuara për secilin vit, rezultojnë se:

Për vitin 2015, gjyqtarja i janë caktuar 145 çështje dhe ka përfunduar 157 çështje. Për pasojë rendimenti i përfundimit të çështjeve është rreth 108%;

Për vitin 2016, gjyqtarja i janë caktuar 132 çështje dhe ka përfunduar 128 çështje. Për pasojë rendimenti i përfundimit të çështjeve është rreth 97%;

Për të dy vitet së bashku, rendimenti mesatar i përfundimit të çështjeve është 103% (102.8 %), tregues i cili sipas Metodologjisë, pikëzohet me 10 pikë.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezultojnë në masën 103%.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtarja pikëzohet me 10 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore,

³¹Duke iu referuar tabelave me të dhëna statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezultojnë se gjyqtarja {...} ka ushtruar detyrën nga data 01.09.2014 deri në datë 31.12.2014, pasi para kësaj date, gjatë vitit 2014 ajo ka qenë me leje shëndetësore dhe për pasojë nuk e ka ushtruar detyrën

sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja {...} i ka arsyetuar vendimet gjyqësore në interval kohor; 2 ditë (shih dosjen 5), 3 ditë (shih dosjen 3), 4 ditë (shih dosjen 1 dhe 4) dhe 7 ditë (shih dosjen 2). Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit {...} ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal. Në rastet e vëzhguara të 3 dokumenteve ligjor dhe 5 dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore me short ka respektuar afatet standarde të gjykimit. Lidhur me kohën e arsyetimit të vendimeve rezultojnë se gjyqtarja i ka kushtuar vëmendje arsyetimit në kohë të vendimeve gjyqësore. Nga 5 dosjet të vëzhguara rezultojnë se vendimet janë arsyetuar brenda afatit ligjor 5 ditë (shih dosja 1, 3, 4 dhe 5) dhe vetëm në 1 rast ky afat ka qenë 7 ditë (shih dosja 2)”*.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Ndërsa referuar Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve me ligjin 38/2017, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari ishte parashikuar 10/ditë (neni 308 paragrafi 2), me përjashtim të rastit kur gjykata vlerësonte shtyrjen e shpalljes së arsyetuar të vendimit me 5 ditë. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal dhe afati 10 ditor i arsyetimit të vendimit civil sipas parashikimeve të nenit 308/2 të K.Pr.Civile.

Sa më sipër, nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezultojnë se:

- (i) Dosja 1, që i përket vendimit me nr. 595, datë 06.11.2015, është dorëzuar në datën 10.11.2015 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;

- (ii) Dosja 2, që i përket vendimit me nr. 489, datë 14.10.2014, është dorëzuar në datën 21.10.2014 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (iii) Dosja 3, që i përket vendimit me nr. 92, datë 22.02.2016, është dorëzuar në datën 25.02.2016 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (iv) Dosja 4, që i përket vendimit me nr. 620, datë 11.12.2014, është dorëzuar në datën 15.12.2014 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (v) Dosja 5, që i përket vendimit me nr. 344, datë 04.10.2014, është dorëzuar në datën 06.10.2014 - (2 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;

Sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Vlorë me shkresën nr.878 prot, datë 23.02.2024, lidhur me 6 nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 30.06.2023, rezulton se:

- (vi) Dosja 6, që i përket vendimit me nr. 2478, datë 12.11.2013, është dorëzuar në datën 15.11.2013 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (vii) Dosja 7, që i përket vendimit me nr. 2485, datë 13.11.2013, është dorëzuar në datën 15.11.2013 - (2 ditë), brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (viii) Dosja 8, që i përket vendimit me nr. 544, datë 11.11.2014, është dorëzuar në datën 17.11.2014 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (ix) Dosja 9, që i përket vendimit me nr.159, datë 01.04.2019, është dorëzuar në datën 07.04.2015 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (x) Dosja 10, që i përket vendimit me nr. 470, datë 15.07.2016, është dorëzuar në datën 21.07.2016 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- (xi) Dosja 11, që i përket vendimit me nr. 585, datë 27.09.2016, është dorëzuar në datën 30.09.2016 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Në Referuar çështjeve sipas kategorive të tyre, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar

- (i) për kategorinë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” është 2.5 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor i përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (ii) për kategorinë “Çështje penale krime”, është 4.6 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar sa më sipër analizuar si në raportin për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor,

ashtu edhe nga të dhënat e sipërcituara në lidhje me dosjet e shortuara rezulton se në tërësi koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar është më shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JOPRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Gjyqtarja {...} ka marrë masat për vënien në lëvizje të çështjes menjëherë përmes vendimeve formale për caktimin e seancës gjyqësore. Konkretisht, është konstatuar se nga marrja e akteve të çështjes me short, ajo vepron duke respektuar afatin 10 ditor të përcaktuar nga neni 333 i K.Pr.Penale. Ndër 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se kanë përfunduar me 1 seancë (shih dosja 2 dhe 5), me 3 seanca (shih dosja 1), me 4 seanca (shih dosja 4) dhe me 5 seanca (shih dosja 3). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 14 seanca, ku 9 seanca kanë qenë produktive, ndërsa 5 seanca kanë qenë joproduktive. Pengesë kryesore në këto 5 seanca joproduktive kanë qenë mungesa e të pandehurit dhe e mbrojtësit në 4 rastet (shih dosja 1, 3 dhe 4) dhe mungesa e prokurorit në një rast (shih dosja 3)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Nga tërësia e të dhënave rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 10³² çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (çështje penale themeli dhe civile themeli) varion nga 1 deri në 9 seanca gjyqësore. Sa i përket numrit të seancave gjyqësore rezulton se: (i) për çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”

³²Duke përjashtuar çështjet pa palë kundërshtare, konkretisht dosjen nr.5, me objekt “Vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi”

numri mesatar i seancave gjyqësore është 6 seanca gjyqësore dhe (ii) për çështje të kategorisë “*Penale krime*” numri mesatar është 2.7 seanca gjyqësore

Numri mesatar i seancave gjyqësore për të 10 çështjet me palë kundërshtare të analizuar, rezulton të jetë 3.4 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short (çështje civile dhe penale themeli me palë), evidentohet se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal (*nenin 158/a dhe 171 e vijues të K.Pr.Civile dhe neni 333 e vijues dhe 342/2 të K.Pr.Penale*). Në çështjet penale data e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatet 10 ditore të përcaktuara në nenin 333 të K.Pr.Penale. Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Përgjithësisht shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: njoftimit i të pandehurit, njoftimi i përsëritur për të paditurin me kërkesë të paditësit, lënien kohë palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim, për shpalljen e vendimit të arsyetuar në një rast etj. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.Penale, përveçse kur distanca nga njëra seancë tek tjetra ka qene më e largët së 15 ditë për shkak të fund vitit e cila përkon me periudhën ku sekretaria gjyqësore kryen veprimin administrativ të mbartjes së dosjeve. Po kështu edhe në çështjet civile konstatohet respektimi i afatit procedural 5 ditor kur seanca është shtyrë për përgatitjen e konkluzioneve me shkrim, sipas përcaktimeve të nenit 305 të K.Pr.Civile, apo shpalljen e arsyetuar të vendimit, sipas përcaktimeve të nenit 308 të K.Pr.Civile. Nga të gjitha seancat gjyqësore të vëzhguara, vetëm në dy raste seancat nuk janë zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarës për arsye shëndetësore (*shih dosjen që i përket vendimit nr.2485, datë 13.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*).

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve³³ të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është mbi 3 seanca, por nga ana tjetër gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për

³³Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “*Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse*”

çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Prandaj pavarësisht se numri mesatar i seancave është më i lartë se 3 (vetëm në çështjet civile të përgjithshme), gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, sepse ajo ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3 vetëm për një kategori çështjesh, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.*

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Gjyqtarja {...} përgjithësisht respekton afatet në caktimin e seancave, kur ligji ka caktuar afat për zhvillimin e tyre. Vetëm në 1 rast është konstatuar seanca e caktuar në tejkalim të afatit procedural 15 ditore të përcaktuar nga neni 342 i K.Pr.Penale për shkak të festave të fundvitit dhe mbartjeve të dosjeve (shih dosja 3). Nga 14 seanca gjyqësore të zhvilluara 11 prej tyre janë çelur me vonesë nga të cilat në 2 seanca vonesa ka qenë nga 11 deri 19 minuta (shih dosja 1), në 4 seanca vonesa nga 4 deri në 9 minuta (shih dosja 2), në 4 seanca vonesa nga 7 deri 19 minuta (shih dosja 4). Nga këto vetëm në dy raste, ku vonesa ka qenë 19 minuta është relatuar shkaku i vonesës, një gjykim tjetër (shih dosja 1 dhe 4). Duhet evidentuar fakti se në të gjitha rastet vonesa nuk ka sjellë pasoja në dështimin e plotë të seancës gjyqësore. Seancat gjyqësore janë zhvilluar në sallë gjyqësore dhe regjistrim

audio. Gjatë gjykimit, gjyqtarja identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme, të cilat janë të arsyetuara dhe në tërësi përmbajnë referenca ligjore. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, prezantimin e gjykatës, nevojën e asistimit të të pandehurit të mitur me praninë e prindërit dhe me caktimin kryesisht të mbrojtësit, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve, deri në shpalljen e vendimit. Ndër 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në asnjë rast çështja e gjykuar prej saj nuk është kthyer për rigjykim për shkelje të procedurave gjyqësore”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtare dhe 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak. Gjyqtarja në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore menjëherë ose deri në 8 ditë pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile dhe penale. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, në përgjithësi mbajtur me regjistrim audio, si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Seancat të cilat nuk janë zhvilluar me sistemin audio janë dokumentuar me procesverbal gjyqësor me shkrim të mbajtur nga sekretarja gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*), ashtu edhe në çështjet penale (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*). Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkaktun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje të vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa 2 deri në 15 minuta që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e

sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Megjithatë konstatohet se në disa seanca (3 seanca) të filluara me më shumë se 18 deri në 58 minuta vonesë nga ora e planifikuar, pavarësisht fillimit me vonesë në asnjë rast nuk rezulton që vonesa të ketë sjellë pasoja në produktivitetin e gjykimit të çështjes. Shkaku i vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore, sipas relatimit të gjyqtarës lidhet me pjesëmarrjen e saj në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat përgatitore dhe gjyqësore të zhvilluara.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 20 pikë.*

2.C. AFTËSIA E GJYQTARËS PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se aktet themelore përgjithësisht janë të rregullta....Renditja e akteve në dosjen gjyqësore lehtëson përdorimin e saj. Fashikulli gjyqësor është i inventarizuar nga sekretarja gjyqësore”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve

është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes në çështjen penale fillon me aktin procedural të shortit, vijon me vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Renditja e dosjes në çështjet civile fillon me aktin procedural të shortit, vijon me vendimin e gjyqtarës për caktimin e seancës përgatitore, kërkesëpadinë dhe provat e paraqitura nga palët, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalet e seancave përgatitore, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë të aftësisë në lidhje me këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar konstatohen se janë përfshirë rregullisht kërkesa e

prokurorit për gjykimin e çështjes së bashku me fashikullin penal dhe provat e tjera, fleta e shortit, vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, aktet e njoftimit të palëve, procesverbali gjyqësor, diskutimet përfundimtare, vendimi gjyqësor me shkrim kompjuterik dhe i zbardhur. Procesverbali i seancës gjyqësore është i plotë me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera që lidhen me përshkrimin e palëve, dokumenton kohën dhe vendin e gjyimit, objektin e akuzës penale, bazën e saj ligjore, si dhe të gjitha veprimet që kryhen në seancë gjyqësore konform kërkesave të nenit 345/1 e 346 të K.Pr.Penale. Në një rast procesverbali ka pasaktësi në pasqyrimin e emrit të gjyqtarës, ku në krye të procesverbalit është pasqyruar emri i një gjyqtareje tjetër (shih dosja 5). Nga ana tjetër, procesverbali është i nënshkruar rregullisht në çdo faqe, si dhe në fund sekretarja gjyqësore dhe gjyqtarja. Vendimet e ndërmjetme janë të arsyetuara dhe tregojnë referencën ligjore, duke respektuar nenin 112 pika 3 të K.Pr.Penale. Vendimi gjyqësor është hartuar si dorëshkrim me kompjuter dhe është nënshkruar në çdo faqe dhe në fund nga gjyqtarja, dhe një kopje i zbardhur me kompjuter i nënshkruar nga gjyqtarja dhe sekretarja gjyqësore”.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (vendimet për vënien në lëvizje të çështjes, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance përgatitore apo gjyqësore, si dhe vendimi përfundimtar) si dhe aktet e paraqitura nga palët (aktet e përfaqësimit të palëve, provat e administruara, konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim, etj.). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} janë paraqitur në Inspektoratin e KLD-së, 2 ankesa, nga ku 1 ankesë e vitit 2014, është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mungesë solemniteti në gjykim dhe ka rezultuar se, nuk ka patur shkelje nga e ana e gjyqtares dhe 1 ankesë e vitit 2014, informacion ardhur nga Kryetari i gjykatës, lidhur me vendimet e cenuara, është verifikuar dhe është vendosur evidentim për efekt vlerësimi profesional dhe etik për gjyqtaren. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për periudhën e rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj saj të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor apo të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore nuk është konstatuar gjykim i çështjeve tej afateve standard, nuk rezulton që ndonjë seancë gjyqësore të jetë shtyrë për mungesë të gjyqtares, si dhe ka vetëm një rast të dorëzimit të vendimit të arsyetuar me vonesë (2 ditë) dhe kjo vonesë nuk ka sjellë pasoja për palën në lidhje me ushtrimin e të drejtës së ankimit, pasi vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët (shih dosja 2). Këto të dhëna janë përshkruar me detaje tek Aftësitë Organizative të Gjyqtarit”.*

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD, trajtuar gjerësisht në pjesën e parë të këtij projektraporti, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që

tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtares.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.590, datë 23.11.2022 rezulton se për subjektin e rivlerësimit {...} janë paraqitur 5 denoncime, për të cilat i janë kërkuar shpjegime subjektit. Pas verifikimit, KPK ka konkluduar lidhur me secilin prej tyre, duke i shqyrtuar dhe trajtuar në kuadër të vlerësimit profesional, por nuk rezultojnë të jenë verifikuar apo trajtuar çështje që mund të ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares, në drejtim të etikës së saj në punë.

Në tërësi, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin e gjyqtares.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” shkalla e aftësisë së gjyqtares është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: “Nga të dhënat e deklaruara nga gjyqtarja {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit 2013-2016, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren janë paraqitur gjithsej 2 ankesa në Inspektoratin e ish KLD.³⁴ Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së me nr. 590, datë 23.11.2022 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me etikën, kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe figurës, ka konkluduar si vijon: *“Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej saj, çmon se:*

- Lidhur me kriterin e pasurisë, duke analizuar konstatimet e mësipërme, çmon se ato nuk janë të tilla që të çojnë në lindjen e dyshimeve për të ardhura të paligjshme, deklarime të rreme apo fshehje të pasurisë. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, vlera e pamjaftueshmërisë financiare, e shpërndarë në dy vite, në raport me provat indirekte të depozituara për të ardhurat para martese, masës dhe impaktit të tyre në gjendjen financiare të subjektit dhe procesit në tërësi, çmohet nga trupi gjykues si rrethanë e pamjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë.

- Lidhur me kriterin e figurës, trupit gjykues nuk i rezultuan elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës apo elemente të tjera që mund të cenojnë figurën e subjektit.

- Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko - profesional, duke marrë parasysh qëllimin e vlerësimit të aftësive profesionale, siç parashikohet nga Kushtetuta, trupi gjykues vlerëson se mangësitë e konstatuara vetëm në një rast për subjektin e rivlerësimit nuk janë të mjaftueshme për të arritur në vlerësimin e saj “me mangësi” ose si “e papërshtatshme”. Sa më sipër, në konkluzionin përfundimtar, trupi gjykues nuk mund të arrijë në një vlerësim tjetër për subjektin e rivlerësimit, përveçse “ e aftë”.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka

³⁴Sikurse pasqyrohet në pjesën e dytë të këtij Projektraporti, të titulluar “Burimet e vlerësimit”

shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARES

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë nënkriter, konkludohet se: *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të gjyqtares {...}. Në asnjë rast nuk është kërkuar përjashtimi i saj nga gjykimi i çështjes. Nuk është konstatuar përdorim. I gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit”.*

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe aktet e çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se: “..Në asnjë rast nuk është kërkuar përjashtimi i saj nga gjykimi i çështjes...”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (*11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja*) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është i paanshëm dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për Statusin, zbatohen për aq sa është e mundur, numri i kërkesave të pranuar te palëve për përjashtimin e gjyqtarës vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “I pakonsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar konkludohet se: “Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse. Në rastet kur iu drejtohet të tretëve me shkresa, konstatohet se gjuha është e sjellshme dhe brenda etikës gjyqësore. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”.

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor,

vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre dhe në çdo rast duke respektuar normat e komunikimit zyrtar dhe etik.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (*për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve, etj.*) është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar konkludohet se “Ne 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarës {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në këtë aspekt, duhet evidentuar se nga 5 çështjet e verifikuara me short janë gjykuar nga gjyqtari i vetëm në 5 raste (shih dosjet , 2, 3, 4 dhe 5)”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimit: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi, si dhe prezumimit se mungesa e të dhënave për trajtimin pa respekt të punonjësve të administratës gjyqësore, keqtrajtimin e tyre nëpërmjet fjalorit të papërshtatshëm, përjashtimit social etj., vlerësohet si shkallë e lartë komunikimi dhe bashkëpunimi të gjyqtares me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indice për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave të tjera për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me

administratën gjyqësore, gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIET TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Gjyqtarja {...} i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Të dhënat e Shkollës së Magjistraturës tregojnë se gjatë periudhës së rivlerësimit ka qenë pjesëmarrëse në 7 trajnime vazhduese pranë Shkollës së Magjistraturës. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtares në fushën civile, penale dhe të marrëdhënieve të punës. Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 10 ditë (për një rast nuk është pasqyruar koha e pjesëmarrjes) të formimit vazhdues për një periudhë tre vjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, përgjithësisht nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me detyrën e gjyqtares së seksionit penal për gjykimin e të miturve, por me tema të tjera lidhur me trukimet në fushën sportive, mbrojtjen e të dhënave personale, shoqëritë tregtare, të drejtat e njeriut dhe marrëdhëniet e punës. Nuk ka të dhëna të dokumentuara që gjyqtarja {...} të jetë angazhuar në aktivitete të tjera profesionale”.*

Sipas të dhënave të pasqyruara në vërtetimin me nr. 673/1 prot., datë 21.10.2016, të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, në periudhën e vlerësimit 2013-2016, rezulton se gjyqtarja {...}, ka qenë pjesëmarrës në 6 aktivitete trajnuese të organizuara nga kjo shkollë, të zhvilluara në 9.5 ditë trajnimi.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, ligji nr. 9877, datë 18.02.2018 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e

pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese apo kohëzgjatjen minimale të këtij angazhimi. Ndërkohë, ky detyrim parashikohet në nenin 23 të ligjit nr.8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit *gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.*

Aktualisht, në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5 të tij, pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar si e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i gjyqtarit, duke përcaktuar edhe kufirin minimal dhe maksimal të pjesëmarrjes gjatë një viti, si dhe gjatë pesë viteve.³⁵ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij, të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi, në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij, që tregojnë ngritjen profesionale. Referuar sa më sipër, pavarësisht se ligji nr. 96/2016 dhe Metodologjia e Pikëzimit e miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk kanë qenë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar nenit 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas formulimit të tij në periudhën e vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarit në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës ka qenë e rregulluar nga ky ligj, duke përcaktuar vetëm kufirin maksimal të angazhimit për 1 dhe 5 vjet dhe jo një detyrim minimal pjesëmarrjeje.

³⁵ Në nenin 5 të Ligjit nr. 96/2016, parashikohet se: “1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. 2. Magjistrati duhet: a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislacionin në fuqi; b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës. 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve. 4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues vetëm në ato raste kur programet e trajnimit janë: a) të përshtatshme për funksionin e tij; b) të organizuara dhe certifikuara nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli. Një kopje e certifikatës vendoset në dosjen personale të magjistratit”.

Sa më sipër, rezulton se gjyqtarja {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 6 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 9.5 ditë trajnimi.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtares në aktivitete trajnuese brenda ose jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, do të jetë 20 pikë, meqenëse për periudhën 3 vjeçare rezulton pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 9.5 ditë trajnimi. Kjo, pasi legjislacioni i kohës parashikonte vetëm kufirin maksimal të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese, por jo një kufi minimal pjesëmarrjeje në aktivitete trajnuese, sikurse përcaktohet aktualisht në nenin 5, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke marrë në konsideratë frekuencën e angazhimit të gjyqtares në aktivitetet trajnuese, sipas të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, si dhe në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, gjyqtarja pikëzohet me 20 pikë.

Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, pikëzohet me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtares në veprimtari trajnuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...} ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lehtësuese dhe as angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 2013-2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si: pjesëmarrje në konferenca shkencore mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit etj.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...} ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me këtë tregues.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, pikëzohet me 0 pikë.

Angazhimi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtares dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE
NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIM**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	90	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	381	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR